

Miratuar më: 2 dhjetor 2022
Publikuar më: 3 mars 2023

Publik
GrecoRC5 (2022)4

RAUNDI I PESTË I VLERËSIMIT

Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në
qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe
agjencitë e zbatimit të ligjit

RAPORTI I PËRPUTHSHMËRISË

SHQIPËRIA



Miratuar nga GRECO
në Mbledhjen e 92 -të Plenare (Strasbourg, 28 nëntor – 2 dhjetor 2022)



Group of States against Corruption
Groupe d'États contre la corruption

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

I. HYRJE

1. Raundi i Pestë i Vlerësimit i GRECO-s trajton “Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në qeverinë qendrore (personave të cilëve u janë besuar funksionet ekzekutive më të larta) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit”.
2. Ky Raport i Përputhshmërisë vlerëson masat e marra nga autoritetet e Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Pestë për Shqipërinë, i miratuar në Mbledhjen e 86-të Plenare të GRECO-s (më datë 29 tetor 2020), publikuar më datë 3 dhjetor 2020, pas autorizimit nga autoritetet e Shqipërisë (GrecoEval5Rep(2019)5).
3. Siç kërkohet nga Rregullorja e Procedurës e GRECO-s¹, autoritetet shqiptare paraqitën një raport të situatës mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në Raportin e Vlerësimit. Ky raport është marrë më datë 30 prill 2022 dhe së bashku me informacionet shtesë, ka shërbyer si bazë për këtë raport.
4. GRECO zgjodhi Greqinë (në lidhje me qeverinë qendrore) dhe Hungarinë (në lidhje me agjencitë e zbatimit të ligjit) për të caktuar Raportuesit për procedurën e përputhshmërisë. Në hartimin e këtij raporti, raportuesit e caktuar - znj. Panagiota Vatikalous në emër të Greqisë dhe z. Bálint Varró në emër të Hungarisë - u ndihmuan edhe nga Sekretariati i GRECO-s.
5. Raporti i Përputhshmërisë shqyrton zbatimin e secilit rekomandim të veçantë të përfshirë në Raportin e Vlerësimit dhe jep një vlerësim të përgjithshëm të nivelit të përputhshmërisë së shtetit anëtar me këto rekomandime. Zbatimi i çdo rekomandimi të papërbushur (pjesërisht ose i pazbatuar) do të vlerësohet në bazë të një Raporti të mëtejshëm të Situatës që do të përcillet nga autoritetet 18 muaj pas miratimit të këtij Raporti Përputhshmërie.

II. ANALIZA

6. GRECO, në Raportin e tij të Vlerësimit, i ka akorduar Shqipërisë 24 rekomandime. Sa më poshtë trajtohet përputhshmëria me këto rekomandime.

Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (në funksionet e larta ekzekutive)

Rekomandimi i

7. *GRECO ka rekomanduar që, për hir të transparencës, emrat e këshilltarëve politikë të publikohen në internet dhe që informacioni mbi punën e tyre kryesore dhe aktivitetet ndihmëse të jetë lehtësisht i aksesueshëm në internet.*
8. Autoritetet shqiptare raportuan se faqet e internetit të Kryeministrisë dhe të të gjitha ministrive, përfshirë ato që i përkasin Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministrinë e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, kanë publikuar në faqet e tyre të

¹ Procedura e Përputhshmërisë e Raundit të Pestë të Vlerësimit të GRECO-s normohet nga Rregullorja e Procedurës, e ndryshuar: Rregulli 31 bis i ndryshuar dhe Rregulli 32 bis i ndryshuar.

internetit emrat e këshilltarëve politikë, si dhe fushën e tyre të ekspertizës dhe dikasterin specifik për të cilin ata janë përgjegjës.

9. GRECO është i kënaqur që, në përputhje me detyrimet ligjore të brendshme (shih, gjithashtu, paragrafin 40 të Raportit të Vlerësimit), emrat e këshilltarëve politikë, puna e tyre kryesore dhe aktivitetet ndihmëse, janë publikuar pothuajse në të gjitha faqet e internetit të ministrive. Ai inkurajon autoritetet të ruajnë të njëjtin nivel transparence në lidhje me publikimin e informacionit të tillë sa herë që përbërja e kabineteve të Kryeministrit dhe të ministrave është subjekt ndryshimi. Në këto rrethana, GRECO vlerëson se ky rekomandim është përmbushur në mënyrë të mjaftueshme.

10. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi i është trajtuar në mënyrë të kënaqshme .

Rekomandimi ii

11. *GRECO ka rekomanduar që i) plane konkrete integriteti të miratohen dhe zbatohen për të gjitha ministrinë, duke përfshirë analizën sistematike të rreziqeve të lidhura me integritetin me të cilat mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë në ushtrimin e detyrave të tyre dhe mekanizmat e monitorimit dhe përputhshmërisë, dhe ii) të hartohen dhe zbatohen masa të përshtatshme korrigjuese që synojnë posaçërisht personat me funksione të larta ekzekutive.*

12. Autoritetet shqiptare raportojnë se Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit (K444), ka koordinuar dhe monitoruar procesin e hartimit dhe miratimit të planeve të integritetit. Rrjedhimisht, nëpër ministri janë ngritur grupet e punës për integritetin, të përbërë nga përfaqësues nga njësi dhe drejtori të ndryshme, me qëllim hartimin e planeve të integritetit. Rreziqet në lidhje me reputacionin, ato ligjore, të përputhshmërisë, operacionale dhe financiare janë identifikuar, vlerësuar dhe renditur sipas ndikimit dhe shpeshësisë, si dhe janë hartuar veprimet përkatëse parandaluese ose zbutëse në bazë të Metodologjisë për Vlerësimin e Rrezikut të Integritetit për institucionet e qeverisë qendrore², të miratuar nga ministri i Drejtësisë. Planet e menaxhimit të rrezikut të integritetit, që përshkruajnë rreziqet e identifikuar dhe përparësitë e tyre, si dhe masat dhe aktivitetet e propozuara për t'u ndërmarrë për t'i parandaluar ose ulur ato, janë miratuar në vitin 2021 nga dhjetë ministri me dikastere specifike qeveritare (me përjashtim të Ministrave të Shtetit pa portofol), plani i integritetit të Ministrisë së Drejtësisë është miratuar pas vizitës vlerësuese në vitin 2020. Ky proces ka përfituar nga përfshirja e administratës publike, si dhe organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Përveç Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të gjitha ministrinë e tjera kanë publikuar në internet planet e integritetit, përfshirë edhe planet e veprimit³.

² https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/4.-Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_EN.pdf

³ Ju lutemi shikoni [këtu](#) planin e veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes; planin e veprimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë [këtu](#); planin e veprimit të Ministrisë së Brendshme [këtu](#); planin e veprimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit [këtu](#); planin e veprimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë [këtu](#); planin e veprimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit [këtu](#); të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale [këtu](#) dhe planin e veprimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural [këtu](#).

13. Për më tepër, Ministri i Drejtësisë, më datë 30 shtator 2021 miratoi Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit⁴, në bazë të së cilës ministrinë do të monitorojnë dhe raportojnë mbi zbatimin e planeve përkatëse të integritetit, mbi bazën e një formulari standard bashkëlidhur asaj metodologjie, në një periudhë gjashtëmujore ose në bazë vjetore. Për të siguruar monitorimin e duhur të zbatimit të planeve të integritetit, të gjitha ministrive të linjës është kërkuar që të caktojnë një koordinator për integritetin. Deri më sot, pesë ministri kanë emëruar koordinatorë për integritetin.

14. Disa plane integriteti përfshijnë masa që synojnë nëpunësit publikë dhe personat me funksione të larta ekzekutive. Për shembull, planet e integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfshijnë një masë për hartimin, miratimin dhe publikimin e një kodi etike i cili do të jetë i detyrueshëm për personelin dhe individët me funksione të larta ekzekutive. Plani i veprimit i Ministrisë së Brendshme përfshin një masë për bërjen publik të informacionit në lidhje me funksionet e këshilltarëve politikë dhe miratimin e një kodi etike që do të mbulojë këshilltarët politikë. Plani i veprimit i Ministrisë së Mbrojtjes parashikon trajnime për integritetin e personave me funksione të larta ekzekutive për tematika të tilla si konflikti i interesit.

15. GRECO mirëpret që, për sa i përket komponentit të parë të pjesës së parë të rekomandimit, planet e integritetit, të plotësuara me plane veprimi, janë vënë në zbatim për të gjitha ministrinë me portofol qeveritare specifike. Pas rishikimit të planeve të integritetit, GRECO ka vërejtur se ato kanë afate të ndryshme kohore për zbatimin e tyre⁵. Shtatë plane veprimi përmbajnë masa të caktuara për të adresuar rreziqet e lidhura me integritetin me të cilat personat me funksione të larta ekzekutive mund të përballen gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Koordinatorët e integritetit, të cilët do të monitoronin zbatimin e planeve të integritetit dhe do të siguronin respektimin e tyre, janë emëruar vetëm në pesë nga njëmbëdhjetë ministri. Në këto rrethana, GRECO vlerëson se kërkohen masa të mëtejshme për të siguruar monitorimin dhe pajtueshmërinë me planet e integritetit në të gjitha ministrinë dhe për të identifikuar masat specifike për të trajtuar rreziqet e lidhura me integritetin që mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë në lidhje me të gjitha planet e integritetit. Për këtë arsye, pjesa (i) e rekomandimit është përmbushur pjesërisht. Për sa i përket pjesës (ii) të rekomandimit, vetëm tre plane veprimi kanë identifikuar masa korrigjuese që trajtojnë rreziqet e lidhura me integritetin për ministrat dhe këshilltarët politikë. Kështu, pjesa (ii) nuk është përmbushur më shumë se pjesërisht.

16. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi ii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi iii

17. *GRECO ka rekomanduar harmonizimin dhe rritjen e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë,*

⁴ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/METODOLOGJIA-E-MONITORIMIT-TE-PLANIT-TE-INTEGRITETIT.pdf>

⁵ Planet e integritetit të shtatë ministrive kanë një afat kohor prej tre vitesh nga 2022 deri në 2025. Plani i integritetit i Ministrisë së Brendshme përfshin periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2024, plani i integritetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbulon periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2023 dhe plani i integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhet me periudhën 2022-2023.

veçanërisht në lidhje me personat me funksione të larta ekzekutive, për shembull, duke hartuar norma dhe rregullore në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategorie dhe për rolin e çdo organi përgjegjës.

18. Autoritetet shqiptare raportojnë se, me urdhër të Kryeministrit të datës 8 nëntor 2021, nën drejtimin e KKKK-së, është krijuar një drejtori e përgjithshme kundër korrupsionit (DPKK). DPKK ka bashkuar njësi të ndryshme ekzistuese në institucione të tjera. DPKK përbëhet nga tre drejtori: drejtorja e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit, drejtorja e programeve dhe projekteve kundër korrupsionit dhe drejtorja operacionale për çështjet kundër korrupsionit. Në vitin 2021 rrjeti i koordinatorëve antikorrupsion, i cili u zyrtarizua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20 tetor 2021, u zgjerua duke përfshirë 44 institucione shtetërore. Për të garantuar efikasitetin e DPKK-së, KKKSH do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të specializuara, si Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Vlerësimin e Pasurive dhe Konflikteve të Interesi (ILDKPKI), Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. KKKK ka publikuar një Udhëzues Antikorrupsion⁶, i cili përmban informacione për përcaktimin, llojet, format, sferat, kriminalizimin dhe raportimin e korrupsionit. Ajo ka publikuar gjithashtu buletine periodike⁷ që tregojnë punën e DPKK-së në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

19. Autoritetet shqiptare kanë parashtruar më tej se përgatitja e një manuali që mbledh të gjitha normat dhe ofron udhëzime për PTEF-të është shtyrë për shkak të hartimit të një projektligji të ri për konfliktin e interesit. Projektligji është aktualisht në shqyrtim nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe pritet që parlamenti ta miratojë para fundit të vitit 2022.

20. GRECO pranon se është bërë progres në lidhje me kuadrin institucional. Në kuadër të zyrës së Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është krijuar Drejtorja e Përgjithshme Kundër Korrupsionit, e cila ka rolin kryesor në koordinimin e luftës kundër korrupsionit. Janë përgatitur dhe publikuar materiale promovuese. GRECO thekson më tej se një projekt-ligj i ri për konfliktin e interesit, një kopje e të cilit nuk i është përcjellë ende GRECO-s për vlerësim, është objekt shqyrtimi nga një komision parlamentar. GRECO beson se projektligji do të përkojë me kërkesat e këtij rekomandimi dhe do të trajtojë problematikat e përfshira në paragrafët 56-59 të Raportit të Vlerësimit. Në këto rrethana, GRECO vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

21. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi iii është zbatuar pjesërisht .

Rekomandimi iv

22. *GRECO ka rekomanduar që i) Kodi Etik Ministror ekzistues të plotësohet me udhëzime konkrete për zbatimin e tij në lidhje me konfliktet e interesit dhe çështje të tjera që kanë lidhje me integritetin (p.sh. dhuratat, kontaktet me palët e treta, lobimin, etj.); ii) të sigurohet funksionimi efektiv i Komisionit të Etikës, ose i çdo mekanizmi tjetër të besueshëm mbikëqyrjeje*

⁶ https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Guida_Antikorrupsioni_-EN.pdf

⁷ Shihni buletin më të fundit në <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/AC-Newsletter-Mars-2022.pdf>

dhe sanksionesh, përfshirë edhe në lidhje me kryeministrin, dhe iii) rregullat etike të plotësohen me shembuj ilustrues dhe mekanizma zbatues për këshilltarët politikë.

23. Autoritetet shqiptare raportojnë se Kodi Etik Ministror (Kodi Ministror)⁸ u rishikua në mënyrë thelbësore më 29 shtator 2021. Ai përmban dispozita që lidhen, ndër të tjera, me (i) detyrimin e anëtarëve të qeverisë për të ruajtur konfidencialitetin e opinioneve të shprehura në vlerësimet dhe diskutimet që zhvillohen pranë Këshillit të Ministrave (neni 5), (ii) detyrimin e ministrave për të respektuar dhe zbatuar legjislacionin e shërbimit civil (neni 10), (iii) detyrimin e ministrave për të zbatuar sjelljen e mirë, objektivitetin dhe paanshmërinë ndaj personelit të ministrisë përkatëse (neni 11), (iv) disa ndalime për anëtarët e Qeverisë kundër, ndër të tjera, marrjes/pranimin të dhuratave ose përfitimeve të tjera, keqpërdorimit të autorizimeve dhe delegimeve që rrjedhin nga kompetencat e tij/saj, duke ndikuar në procesin e vendimmarrjes ose marrjen e vendimeve në favor të anëtarëve të familjes së tij/saj dhe personave të tjerë të lidhur me ta (neni 12 dhe 29), përdorimin e burimeve publike për përfitime personale ose politike (neni 13), (v) detyrimin e ministrave për të bërë publike, të paktën çdo tremujor, detaje rreth takimeve që ministrat organizojnë me shtetas dhe subjekte vendase dhe të huaja (neni 20), (vi) detyrimin e anëtarëve të Këshillit të Ministrave për të deklaruar konfliktin e interesit *ad hoc* gjatë një procedure vendimmarrjeje përpara Këshillit të Ministrave, ministrisë ose një institucioni tjetër në varësi të ministrisë (neni 25), (vii) kufizime të caktuara për anëtarët e qeverisë për të ushtruar veprimtari të jashtme (neni 26) dhe kufizime pas largimit nga detyra (neni 37). Kodi është i detyrueshëm për anëtarët e Qeverisë, duke përfshirë zëvendësministrat. Një manual i dedikuar është në përgatitje e sipër nga Ministri i Shtetit për Standardet.

24. Komisioni i Etikës, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 90, datë 20 maj 2022 dhe i përbërë nga Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe Drejtori i Drejtorisë Rregullore dhe Përputhshmërisë – tre të fundit anëtarë të korpusit të nivelit të lartë drejtues të shërbimit civil⁹, është i autorizuar të interpretojë dispozitat e Kodit Ministror, të japë mendim këshillues me kërkesë të një anëtari të Qeverisë ose të përcaktojë nëse sjellja e një anëtari të Qeverisë ka shkelur dispozitat e tij. Në rast të shkeljes së dispozitave të tij, ai jep një mendim me shkrim duke rekomanduar dhënien e masës disiplinore nga Kryeministri, i cili mund (i) të japë vërejtje (ii) t'i kërkojë anëtarit të Qeverisë të bëjë një falje publike ose të japë dorëheqjen, (iii) paralajmërim për shkarkim nga detyra, (iv) të fillojë procedurën për shkarkimin nga detyra. Autoritetet theksojnë më tej se është ILDKPKI autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9367/2005 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

25. GRECO mban shënim Kodin e rishikuar Ministror, çka dëshmon vullnetin e mirë të autoriteteve për të trajtuar rekomandimet e GRECO-s. Për sa i përket pjesës (i) të këtij rekomandimi, përgatitja e një manuali shpjegues¹⁰ është në hartim e sipër, megjithëse GRECO

⁸ <https://qbz.gov.al/preview/079d9de1-48f2-4e7d-adf5-ecce3ac74274/cons/20220506>

⁹ Paragrafi 33 i Raportit të Vlerësimit dilte në përfundimin se “Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, si dhe sekretarët e përgjithshëm brenda ministrave të veçanta, të cilët drejtojnë strukturat administrative të ministrave, nuk bëjnë pjesë në kategorinë personave me funksione të larta ekzekutive”.

¹⁰ Neni 29 (7) i Kodit Ministror parashikon se “Ministri përgjegjës për standardet, pas konsultimit me ILDKPKI, harton një manual shpjegues për zbatimin e detyrimeve në lidhje me dhuratat, favoret dhe trajtimin preferencial, të përcaktuara në Kod”.

nuk ka marrë ende një kopje të tij. Kjo pjesë pra nuk është përmbushur, qoftë edhe pjesërisht. Për sa i përket pjesës (ii), është ngritur Komisioni i Etikës, çka është një hap në drejtimin e duhur. Përbërja e tij përbëhet nga shumica e përfaqësuesve nga trupat e nivelit të lartë drejtues të shërbimit civil. Megjithatë, GRECO shpreh shqetësime serioze për praninë e një anëtari të Qeverisë në përbërjen e tij, në diskutime dhe procesin e votimit, gjë që do të pengonte funksionimin e tij efektiv, në veçanti pavarësinë dhe paanshmërinë e tij nga ekzekutivi¹¹. Roli i tij është kufizuar në paraqitjen e një rekomandimi për marrjen e masës disiplinore nga Kryeministri në rast se një ministër ka shkelur dispozitat e tij. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë kur Kryeministri shkel ndonjë nga dispozitat e Kodit Ministror (shih edhe paragrafin 65 të Raportit të Vlerësimit). Kodi Ministror përmban dispozita të gjera që shkojnë përtej plotësimit të deklaratave të interesave private, shqyrtimi i të cilave është kompetencë e ILDKPKI sipas ligjit për konfliktin e interesit. Në këto rrethana, GRECO vlerëson se kjo pjesë e rekomandimit është përmbushur pjesërisht për shkak të ngritjes së Komisionit të Etikës, në varësi të rishikimit të përbërjes së tij për sa i përket heqjes nga marrja pjesë në të e një anëtari të qeverisë dhe funksionimit të tij efektiv në të ardhmen. Së fundmi, autoritetet nuk kanë dhënë asnjë informacion në lidhje me zbatimin e pjesës (iii) të rekomandimit i cili mbetet i pazbatuar. Për ta përmbledhur, GRECO konsideron se vetëm pjesa (ii) e këtij rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

26. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi iv është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi v

27. *GRECO ka rekomanduar që anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë t'i nënshtrohen ndërgjegjësimit sistematik për çështje që lidhen me integritetin, duke përfshirë Kodin Etik Ministror dhe legjislacionin dhe kuadrin kundër korrupsionit dhe integritetit, nëpërmjet trajnimeve të rregullta, udhëzimeve të dedikuara dhe këshillimit konfidencial.*

28. Autoritetet shqiptare raportojnë se, sipas Kodit të Ministrave, anëtarët e Këshillit të Ministrave mund t'i drejtohen Komisionit të Etikës ose ILDKPKI në rast të një konflikti aktual ose të mundshëm interesi. Neni 25 i Kodit Ministror thotë se Ministri i Shtetit për Standardet, pas konsultimit me ILDKPKI, mundëson një përmbledhje të rregullave të etikës për ministrat në një manual të vetëm, me udhëzime konkrete për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni për konfliktin e interesit. Gjithashtu, ai/ajo siguron organizimin e aktiviteteve periodike ndërgjegjësuese për anëtarët e Këshillit të Ministrave të paktën një herë në tre muaj. Më datë 18 maj 2022, Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet zhvilloi një sesion trajnimi për anëtarët e Këshillit të Ministrave mbi Kodin Ministror të rishikuar. Ministri i Shtetit për Standardet paraqiti raste ilustruese të konflikteve të mundshme të interesit dhe shkeljeve të mundshme të dispozitave të Kodit Ministror. Sesioni i ardhshëm i trajnimit pritet të zhvillohet pas miratimit të manualit, përgatitja e të cilit është në vijim e sipër.

29. Gjithashtu, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29 shtator 2021¹², lidhur me rregullat për zbatimin e parimeve të etikës, klasifikimin e veprimtarive të jashtme dhe vlerën

¹¹ Paragrafi 2 i Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 20 maj 2022, parashikon si më poshtë: "Komisioni i Etikës kryesohet nga Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet dhe përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe Drejtori i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë".

¹² <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/09/29/874>

e dhuratave për nëpunësit e administratës publike, shtrin zbatimin e tij edhe për këshilltarët politikë. Sipas vendimit, njësia e burimeve njerëzore të çdo ministrie është përgjegjëse për këshillimin në lidhje me çështje të etikës dhe integritetit në fillimin e punësimit, gjatë punësimit dhe rast pas rasti, dhe trajnimi për etikën dhe integritetin ofrohet nga institucioni kompetent për trajnimin e nëpunësve të administratës publike. Ministri të veçanta, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit dhe Sportit, organizuan përkatësisht takime ndërgjegjësuere me këshilltarët politikë në datat 1 dhe 10 mars 2022, duke i informuar ata për kuadrin ligjor në lidhje me integritetin dhe antikorrupsionin. Më 28 Prill 2022, KKKK dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike zhvilluan një trajnim për disa këshilltarë politikë mbi menaxhimin e etikës dhe planet e integritetit. Përveç më shumë, Udhëzuesi Kundër Korrupsionit i Ministrisë së Drejtësisë (shih paragrafin 18më lart) është shpërndarë ministrive të ndryshme në rrugë elektronike.

30. GRECO vëren se është zhvilluar një sesion trajnimi mbi Kodin Ministror të rishikuar përsa u përket anëtarëve të Qeverisë dhe janë organizuar disa trajnime sporadike për këshilltarët politikë për çështje të lidhura me integritetin. GRECO u bën thirrje autoriteteve të kryejnë trajnime të rregullta për anëtarët e Qeverisë, siç kërkohet nga vetë Kodi Ministror. Për sa i përket këshillimit konfidencial, GRECO vëren se Komisioni i Etikës do të japë rekomandim me shkrim sa herë që një anëtar i Këshillit të Ministrave kërkon me shkrim një interpretim për çështjet e parashikuara nga Kodi Ministror (paragrafi 8 i Urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 22 maj 2022). Megjithatë, duke pasur parasysh shqetësimet e tij të mësipërme për mungesën e pavarësisë së Komisionit të Etikës (shih paragrafin 25më lart), progresi aktual i këtij komponenti të rekomandimit do të duhet të vlerësohet në një fazë të mëvonshme kur të sigurohet informacioni që anëtarët e Këshilli i Ministrave kanë kërkuar në fakt këshilla për interpretimin e Kodit Ministror. Rrjedhimisht, GRECO vlerëson se ky rekomandim nuk është përmbushur më shumë se pjesërisht.

31. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi v është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi vi

32. *GRECO ka rekomanduar që të ndërmerren masa plotësuese për ta bërë procesin e konsultimit të projekt-legjislacionit parësor dhe dytësor me interes publik specifik më efektiv për palët veçanërisht të interesuara, edhe nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit më të lehta për t'u përdorur nga përdoruesit.*

33. Autoritetet shqiptare vënë në dukje raportin e vitit 2021 mbi ecurinë e konsultimit publik, i cili është publikuar online në faqen e internetit të Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike¹³ (Regjistri). Sipas raportit, nga gjithsej 303 projektligje parësore dhe dytësore të parashikuara për t'u miratuar në vitin 2021, 220 mbuloheshin nga njëri nga përjashtimet e parashikuara në Ligjin për Konsultimin Publik (Ligji nr. 146/2014¹⁴) dhe nuk i nënshtroheshin procedurës së konsultimit publik. Megjithatë, konsultimet publike janë kryer në lidhje me 29 projektligje parësore dhe dytësore nga gjithsej 44 për të cilat konsultimet

¹³

https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/Raporti_Vjetor_Performances_Konsultimit_Publik_25022022.pdf

¹⁴ Në paragrafin 81 të Raportit të Vlerësimit, ligji është referuar padashur si Ligji nr. 146/2019, referenca e saktë është Ligji nr. 146/2014.

publike kërkoheshin me ligj, në një normë prej 65.9% krahasuar me 79.57% në vitin 2020. Afati ligjor njëzet ditor për kryerjen e konsultimeve publike është respektuar për të gjithë projektligjet parësore dhe dytësore të cilat janë publikuar edhe në Regjistër. Mjete të tjera të konsultimeve publike përfshijnë përdorimin e postës elektronike, takimet publike, komitetet konsultative dhe faqet e internetit të ministrive të linjës. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në konsultime publike ishte 1,396, nga të cilët vetëm 550 persona kanë dhënë kontribute krahasuar me 1,565 në vitin 2020 dhe 581 në vitin 2019 që kanë paraqitur komente dhe/ose rekomandime. Raportet mbi kontributet/konsultimet publike janë përgatitur dhe publikuar në lidhje me 26 projektligje parësore dhe dytësore¹⁵. Nga 762 komente të pranuar, 555 janë pranuar plotësisht ose pjesërisht, ndërsa 207 janë refuzuar. Cilësia e përgjithshme e performancës institucionale kundrejt konsultimit publik ka pësuar rënie në krahasim me vitet 2020 dhe 2019 për shkak të performancës jo të përshtatshme të disa ministrive të linjës. 77 projektligje parësore dhe dytësore nga gjithsej 284 që janë parashikuar të miratohen në vitin 2022¹⁶ do të jenë objekt i konsultimit publik.

34. Autoritetet parashikojnë më tej se, për të përmirësuar procesin e konsultimit, në korrik 2022 u ndërmorrën iniciativat e mëposhtme: (i) identifikimi nga ministrinë e linjës, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, të palëve të mundshme të interesit, të cilat do të regjistrohen në Regjistër dhe automatikisht do të marrin njoftime kur projektligjet do të publikohen online për konsultim publik. Procesi është në vijim e sipër, pasi vetëm nëntë ministri të linjës kanë identifikuar palë të mundshme të interesuara. (ii) Faqja e internetit e Regjistrit (www.konsultimipublik.gov.al) është ripërtërirë për ta bërë atë më të lehtë për përdoruesit. Motori i kërkimit lejon shfaqjen e informacionit sipas sektorit, institucionit dhe statusit të konsultimit. Përdoruesit mund të abonohen për të marrë njoftime mbi statusin e publikimeve sipas institucionit ose sektorit.

35. GRECO vëren se duket se është respektuar afati kohor ligjor për konsultimet publike, gjë që është një hap në drejtimin e duhur. Ajo pranon se disa nisma, si rinovimi i faqes zyrtare të internetit për konsultim publik dhe identifikimi i palëve të interesuara të mundshme që do të marrin njoftimin automatik për publikimin e projektligjeve, janë prezantuar së fundmi për të rritur cilësinë e konsultimit publik. Megjithatë, GRECO vë në dukje gjithashtu se performanca institucionale ndaj konsultimit publik ka pësuar rënie, ashtu si dhe shkalla e projektligjeve që i nënshtrohen konsultimit publik nga viti 2020 deri në vitin 2021 (65.9% në 2021 krahasuar me 79.57% në 2020) dhe, gjatë vitit 2022, shkalla shfaqet në nivelin e 72.73% në vitin 2022. GRECO vëren më tej se projektligjet me interes të veçantë publik janë publikuar në Regjistër, praktikë e cila, sipas raporteve gjashtëmujore të konsultimeve publike të publikuara nga ministrinë e linjës për vitin 2022¹⁷, nuk kanë marrë asnjë kontribut nga publiku. Edhe numri i kontributeve në vitin 2021 ka shënuar rënie (550) krahasuar me vitin 2020 (1565) dhe vitin 2019 (581). Në këto rrethana, GRECO u bën thirrje autoriteteve të rrisin masat për ta bërë efikas procesin e

¹⁵ Shih, për shembull, <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/293> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/319> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/320> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/263> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/341> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347> ;

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/429> .

¹⁶ https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/Plani_Vjetor_Konsultimit_Publik_2022.pdf

¹⁷ <http://www.konsultimipublik.gov.al/Raporte>

konsultimit publik, për shembull, duke i bërë faqet e internetit të ministrive të linjës më të lehta për përdoruesit, siç përshkruhet në paragrafin 80 të Raportit të Vlerësimit dhe kërkohet nga rekomandimi, dhe duke i dhënë formën përfundimtare procesit të hartimit të palëve të mundshme të interesit që do të përfshiheshin drejtpërdrejt në procesin e konsultimit për gjitha ministritë e linjës.

36. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi vi është zbatuar pjesërisht .

Rekomandimi vii

37. *GRECO ka rekomanduar që i) të përcaktohen rregulla të detajuara se si personat e besuar me funksione të larta ekzekutive angazhohen në kontakte me lobistët dhe palë të tjera të treta që kërkojnë të ndikojnë në legjislativin qeveritar dhe veprimtari të tjera, dhe ii) të sigurohet transparencë e mjaftueshme për qëllimin e këtyre kontakteve (formale dhe joformale), identitetin e personit (personave) me të cilët (ose në emër të të cilëve) janë marrë kontaktet dhe çështjet specifike të diskutuara.*

38. Autoritetet shqiptare raportojnë se neni 26 i Kodit Ministror është plotësuar me një dispozitë, sipas së cilës anëtarët e Qeverisë duhet të zhvillojnë takime me përfaqësues të biznesit/grupeve të interesit në prani të dy zyrtarëve të lartë të ministrisë përkatëse. Do të mbahet një procesverbal, i cili përmban identitetin e personave të përfshirë në takim dhe çështjet e diskutuara, i cili do të regjistrohet nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përkatëse. Anëtarët e Qeverisë mund të konsultohen në mënyrë konfidenciale me Komisionin e Etikës për përfshirjen e tyre në aktivitete me palë të treta. Për sa i përket këshilltarëve politikë, autoritetet theksojnë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29 shtator 2021 (shih paragrafin 28më lart), neni 6 (c) (i) i të cilit parashikon se zyrtari i administratës publike duhet të shmangë situatat, veprimet ose sjelljet që dëmtojnë ose mund të dëmtojnë imazhin e administratës publike, si p.sh. shoqërimin me individë privatë që mund të kenë interesa të lidhura në veprimtarinë e ministrisë për të cilën punojnë ose shoqërimin me persona të përfshirë në veprimtari të paligjshme.

39. GRECO vëren se, në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, rregullat e zbatueshme për këshilltarët politikë duket se ndalojnë kontaktet e tyre me lobistët dhe palë të tjera të treta. Megjithatë, takimet ndërmjet lobistëve/palëve të treta dhe anëtarëve të Qeverisë do të zhvillohen në prani të dy nëpunësve publikë. Megjithatë, dispozitat e Kodit Ministror nuk përmbajnë rregulla të detajuara se si anëtarët e qeverisë duhet të angazhohen, mbajnë dhe bëjnë të ditura kontaktet që kanë me lobistët dhe palët e tjera të treta, për shembull, nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit, si p.sh., nëpërmjet postës elektronike, thirrje telefonike dhe me video ose mesazheve tekst. GRECO mban shënim krijimin e një regjistri që do të mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i çdo ministrie dhe shkon në njëfarë mënyre drejt zbatimit të pjesës (ii) të rekomandimit. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për plotësimin e regjistrit bazuar në informacionin e dhënë nga dy nëpunësit publikë që janë pjesëmarrës në takimet mes personale me funksione të larta ekzekutive dhe lobistëve dhe palëve të tjera të treta. Thënë kjo, transparenca e mjaftueshme do të sigurohej nëse regjistri do të vihej në dispozicion të publikut në internet dhe do të përditësohej rregullisht. Për arsyet e parashtruara më sipër, GRECO vlerëson se të dyja pjesët e rekomandimit nuk janë përmbushur më shumë se pjesërisht.

40. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi vii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi viii

41. *GRECO ka rekomanduar që abstenimi i një ministri ose zëvendësministri për të qenë pjesë e një vendimi të Këshillit të Ministrave për shkak të një konflikti të mundshëm interesi të regjistrohet në procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, siç kërkohet me ligj.*

42. Autoritetet shqiptare raportojnë se procesverbalet e mbledhjeve të Qeverisë nuk janë publike. Ato nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe depozitohen në zyrën e protokollit të Kryeministrit. Ka pasur një rast abstenimi të një ministri nga miratimi i një projektvendimi nga Këshilli i Ministrave më datë 2 mars 2022 për shkak të një konflikti të mundshëm interesi, i cili u regjistrua në procesverbalin e mbledhjes. Zëvendësministrat nuk kanë të drejtë vote kur marrin pjesë në mbledhje në vend të ministrave.

43. GRECO vëren se ka pasur vetëm një rast që një ministër ka abstenuar nga procesi i vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, i cili sipas autoriteteve është regjistruar në procesverbalin e mbledhjes. Megjithatë, GRECO vlerëson se zbatimi i ardhshëm i këtij rekomandimi duhet të mbahet nën shqyrtim dhe se autoritetet të hetojnë ose kontrollojnë rregullisht ekzistencën e konfliktit aktual ose të mundshëm të interesave përpara ose gjatë procesit të vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave dhe ta dokumentojnë atë faktikisht në procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.

44. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi viii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi ix

45. *GRECO ka rekomanduar të sigurohet që rregullat e qarta për kufizimet pas largimit nga detyra të zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për këshilltarët politikë dhe se të zbatohet një mekanizëm efektiv zbatues në lidhje me këto rregulla për të gjithë personat të besuar me funksione të larta ekzekutive.*

46. Autoritetet shqiptare i referohen nenit 37 të Kodit Ministror, përmbajtja e të cilit është përshkruar në paragrafin 114 të Raportit të Vlerësimit. Kështu, një anëtar i qeverisë nuk ka të drejtë të emërohet në poste drejtuese ose të përfshihet në kontrollin e shoqërive publike ose private për një vit pas largimit nga detyra, nëse ai/ajo ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në veprimtarinë tregtare të këtyre shoqërive gjatë një periudhe dyvjeçare përpara përfundimit të mandatit. Përgjatë kësaj, ky kufizim do të përcaktohet nga Komisioni i Etikës nëpërmjet një vendimi me shkrim. Për këshilltarët politikë, autoritetet i referohen vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29 shtator 2021 (shih paragrafin 28më lart), neni 7 i të cilit rregullon përdorimin e informacionit zyrtar dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Sipas nenit 7, pika (2), një ish-zyrtar i administratës publike nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një mosmarrëveshje ose në marrëdhënie biznesi me administratën publike, për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga detyra, në lidhje me detyrat që ai/ajo ka kryer. Në rast punësimi përpara periudhës dyvjeçare, ish-zyrtari duhet të informojë njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punonte, të paktën dy javë përpara fillimit të punës së re. Njësia e burimeve njerëzore do të vlerësojë informacionin dhe do të informojë me shkrim ish-zyrtarin për vendimin e saj.

47. GRECO vëren se situata ka mbetur e pandryshuar si në momentin e miratimit të Raportit të Vlerësimit. Ndërkohë që Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim të ri në vitin 2021 për këshilltarët politikë, GRECO vlerëson se kufizimi pas largimit nga detyra i parashikuar aty (veçanërisht në neni 7.2¹⁸) është i njëjtë me atë të përfshirë në nenin 17¹⁹ të ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i cili përshkruhet në paragrafin 115 të Raportit të Vlerësimit. Për më tepër, autoritetet duhet ende të demonstrojnë efikasitetin e njësive të burimeve njerëzore në verifikimin e kufizimeve pas largimit nga detyra dhe vendosjen e sanksioneve të duhura për shkeljet e tyre. Në këto rrethana, rregullat e zbatueshme si për anëtarët e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për këshilltarët politikë nuk përmbajnë asnjë ndalim të shprehur për t’u punësuar (dmth, për të krijuar një marrëdhënie pune ose biznesi çfarëdo qoftë) në sektorë të veçantë gjatë një kohe të caktuar kur mund të krijohet një lidhje ndërmjet veprimtarive të kryera më parë nga anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë dhe veprimtaritë e sektorit të caktuar. GRECO vëren më tej se efikasiteti i kufizimeve pas largimit nga detyra në lidhje me anëtarët e qeverisë varet nga përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Etikës, në lidhje me të cilin GRECO ka shprehur shqetësime serioze në paragrafin 25më sipër. GRECO konstaton se asnjë nga kërkesat e këtij rekomandimi nuk është përmbushur.

48. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi ix nuk është zbatuar.

Rekomandimi x

49. *GRECO ka rekomanduar që e-platforma e krijuar për deklarimin dhe publikimin e deklaratave të pasurisë dhe interesit të vihet në funksion sa më shpejt të jetë e mundur.*

50. Autoritetet shqiptare raportojnë se e-platforma u testua në vitin 2021 për disa institucione. Çdo çështje teknike që lindte nga testimi është zgjidhur në kohën e duhur. Në tetor dhe nëntor 2021 u miratua formulari elektronik për deklarimin e pasurisë dhe interesave private dhe më datën 1 nëntor 2021 ILDKPKI ka nxjerrë udhëzimin në lidhje me procedurën e plotësimit të e-deklarimeve të pasurisë dhe interesave private. Nga tetori deri në dhjetor 2021, ILDKPKI ka zhvilluar aktivitete trajnimi me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave private nga çdo deklarues dhe person i lidhur. Si rrjedhojë, nga data 1 janar 2022 ILDKPKI ka vënë në funksion sistemin elektronik²⁰ të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave dhe i pranon deklaratat vetëm në mënyrë elektronike. Aktivitetet trajnuese kanë vijuar edhe në vitin 2022.

51. GRECO mban shënim informacionin e dhënë nga autoritetet dhe është i kënaqur me funksionimin e plotë të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave.

¹⁸ Neni 7 (2) i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29.09.2021 parashikon si më poshtë: “Ish-nëpunësi i administratës publike nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare, për një periudhë kohe 2-vjeçare pas largimit nga detyra, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj”.

¹⁹ Neni 17 i ligjit nr. 9131/2003 shprehet si më poshtë: “Për një periudhë kohe 2-vjeçare, pas largimit nga detyra, ish-nëpunësi nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj”.

²⁰ <https://deklarimi.ildkpi.al/Account/Login?ReturnUrl=%2F>

52. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi x është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Rekomandimi xi

53. *GRECO ka rekomanduar që të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore, financiare dhe të tjera, në mënyrë që ILDKPKI të përmirësojë kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklaratave të pasurisë dhe interesave private.*

54. Autoritetet shqiptare raportojnë se kuadri ligjor për funksionimin e ILDKPKI-së është krijuar dhe zbatimi i tij po konsolidohet me burime njerëzore dhe financiare në rritje. Punonjësit e ILDKPKI-së kanë ndjekur disa trajnime për veprat penale në fushën e pastrimit të parave dhe hetimit financiar. Në bashkëpunim me Programin e Mbështetjes Horizontale II të Këshillit të Evropës janë organizuar sesione trajnime për verifikimin dhe hetimin e deklaratave të interesave private, duke synuar një këndvështrim krahasues me praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), është zhvilluar edhe një tjetër aktivitet trajnime mbi praktikën më të mira për identifikimin, hetimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me to. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ILDKPKI ka marrë pjesë në një aktivitet trajnime të organizuar nga Nisma Rajonale Antikorrupsion (NRA) për njohjen dhe shkëmbimin e përvojave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Burimet e përgjithshme financiare të akorduara nga buxheti i shtetit janë rritur me 37% nga viti 2019 deri në vitin 2021, si më poshtë: në vitin 2019 142,700,000 lekë (1,204,255 EUR), në vitin 2020, 158,500,000 lekë (1,337,953 Euro), dhe 195,944,00 lekë (1,653,585 Euro). Buxheti i alokuar për burimet njerëzore ka dëshmuar gjithashtu një rritje nga viti 2019 në 2021 si vijon: 985,000 Euro në vitin 2019, 1,002,166 Euro në vitin 2020 dhe 1,052,666 Euro në vitin 2021.

55. GRECO mirëpret që alokimet nga buxheti i shtetit për ILDKPKI kanë pësuar rritje të qëndrueshme ndër vite. Anëtarët e stafit të saj, numri i të cilëve ka mbetur i qëndrueshëm gjatë gjithë kësaj kohe, kanë përfituar gjithashtu nga një sërë aktivitete trajnime dhe GRECO inkurajon autoritetet që të vazhdojnë të rrisin ekspertizën dhe aftësitë e inspektorëve të ILDKPKI në të ardhmen. Në këtë kontekst, GRECO vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

56. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xi është zbatuar në mënyrë të kënaqshme

Rekomandimi xii

57. *GRECO ka rekomanduar që i) rekrutimi i personelit të prokurorisë dhe stafit teknik në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) të përfundojë si çështje me përparësi dhe që punonjësit e saj të pajisen me burimet e duhura njerëzore dhe teknike dhe prokurorët të përfitojnë nga trajnime shumë të specializuara, dhe ii) të kryhet efektivisht bashkëpunimi i duhur me ILDKPKI për të rritur zbatimin efektiv të raporteve të ILDKPKI në rastet e shkeljes nga personat e besuar me funksione të larta ekzekutive dhe punonjësit e policisë të ligjeve për konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurisë.*

58. Autoritetet shqiptare raportojnë se, që nga muaji dhjetor 2021, pas emërimit të katër prokurorëve, SPAK përbëhet aktualisht nga shtatëmbëdhjetë prokurorë të emëruar për një

mandat nëntëvjeçar dhe është bërë plotësisht funksional. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) është plotësuar me gjashtëdhjetë hetues. Si SPAK ashtu edhe BKH kanë vijuar me rekrutimin e personelit administrativ dhe atij mbështetës, të cilët i janë nënshtruar verifikimit të zgjeruar. Nga 84 punonjës të parashikuar në organikën e SPAK, janë emëruar 81. Në vitin 2021 si dhe nga janari deri në mars 2022 janë kryer disa trajnime për prokurorët e SPAK dhe hetuesit e BKH-së për çështje në lidhje me hetimin penal të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në muajin mars 2022 u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis SPAK dhe ILDKPKI për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e luftës kundër krimeve të kryera nga zyrtarët e lartë të administratës publike, të zgjedhurit dhe nëpunësit publikë. Ai do të jetë në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, të dy institucionet do të caktojnë një koordinator i cili do të shërbejë si pikë kontakti për shkëmbimin e informacionit. Si rezultat, të dyja institucionet kanë bashkëpunuar në pesëmbëdhjetë raste dhe shkëmbimi i informacionit është intensifikuar përmes koordinatoreve përkatës. ILDKPKI dhe SPAK angazhohen për hartimin e një metodologjie në lidhje me procedurat e hetimit administrativ dhe referimit të veprave penale. Do të zhvillohen takime të përbashkëta dhe trajnime periodike ndërmjet inspektorëve të ILDKPKI dhe prokurorëve të SPAK për shkëmbimin e përvojave.

59. GRECO mirëpret që, për sa i përket pjesës (i) të rekomandimit, SPAK është plotësuar me 17 prokurorë, me një mandat nëntëvjeçar dhe është bërë plotësisht funksional. Ai thekson gjithashtu se 60 hetues kanë filluar punësimin pranë BKH-së. Për më tepër, si prokurorët ashtu edhe hetuesit kanë marrë trajnime të vazhdueshme për tematika që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Gjithashtu, pozicionet për personelin administrativ dhe mbështetës të SPAK janë plotësuar pothuajse plotësisht. Për sa i përket pjesës (ii) të rekomandimit, është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet SPAK dhe ILDKPKI, e cila ka sjellë rritjen e asistencës dhe intensifikimin e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet dy institucioneve. GRECO inkurajon të dy institucionet që të vazhdojnë të rrisin bashkëpunimin e tyre në të ardhmen. Në këtë kontekst, GRECO konsideron se të dyja pjesët e rekomandimit janë përmbushur plotësisht.

60. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në agjencitë e zbatimit të ligjit

Rekomandimi xiii

61. *GRECO ka rekomanduar (i) që të kryhet një analizë e gjerë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e dhurimeve dhe sponsorizimeve private për Policinë e Shtetit dhe që, nën dritën e gjetjeve të saj, të miratohen rregulla për të hequr dorë nga dhurimet/sponsorizimet private për Policinë ose, si minimum, të kufizohen rreziqet e korrupsionit dhe konfliktet e interesit në këtë drejtim; dhe (ii) që dhurimet dhe sponsorizimet e marra të publikohen në baza të rregullta (përfshirë edhe në internet), duke treguar natyrën dhe vlerën e secilit dhurim si dhe identitetin e donatorit.*

62. Autoritetet shqiptare raportojnë se në muajin shkurt 2021 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (DPPSH) ka nxjerrë urdhrin për përcaktimin e procedurave standarde të punës për rregullat në lidhje me marrjen dhe administrimin e donacioneve nga Policia e Shtetit. Sipas relacionit shpjegues bashkëlidhur atij urdhri, administrimi i donacioneve rregullohej më parë me një udhëzim të Ministrit të Brendshëm (nr. 1150, datë 16.07.2007),

baza ligjore e të cilit ishte shfuqizuar. Gjithashtu, Ministria e Financave ka miratuar disa akte nënligjore në lidhje me dhurimet, pastrimin e parave dhe konfliktin e interesit, të cilat duhet të merren parasysh kur bëhen dhurime/sponsorizime për Policinë. Autoritetet shtojnë se, falë kërkesave në rritje për të bërë publike dhurimet, ato janë publikuar si lajme në një faqe interneti të dedikuar²¹ të Policisë së Shtetit, që përmban informacione për natyrën dhe vlerën e dhurimeve si dhe identitetin e donatorëve. Ka patur dhe njoftime të tjera të publikuara në faqe interneti të veçanta²². Lajmet janë plotësuar me foto dhe/ose video.

63. GRECO mban shënim informacionin e paraqitur nga autoritetet. Për sa i përket pjesës (i) të rekomandimit, ndërkohë që urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit i është bashkëlidhur një relacion i shkurtër shpjegues, i cili ka ruajtur praktikën e marrjes së dhurimeve/sponsorizimeve, autoritetet nuk kanë bërë një analizë të gjerë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën mbi dhurimet dhe sponsorizimet për Policinë. GRECO vlerëson se kjo pjesë e rekomandimit nuk është përmbushur, qoftë edhe pjesërisht. Për sa i përket pjesës (ii) të rekomandimit, GRECO mirëpret ngritjen e një faqeje interneti të dedikuar për dhurimet dhe sponsorizimet. Ai gjithashtu ka vërejtur se ka pasur publikime të njoftimeve të tjera të ngjashme në faqe të tjera në internet. Ndërkohë që GRECO konsideron se kjo pjesë e rekomandimit është përmbushur, ai inkurajon autoritetet që të zbatojnë një qasje të koordinuar për publikimin e dhurimeve dhe sponsorizimeve duke publikuar të gjitha lajmet në faqen e dedikuar për dhurimet.

64. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xiii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xiv

65. *GRECO ka rekomanduar që politikat për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës të marrin parasysh në mënyrën e duhur rreziqet për korrupsion dhe konfliktin e interesit.*

66. Autoritetet shqiptare raportojnë se Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 591/2022²³ "Për miratimin e llojeve të shërbimeve shtesë që ofron Policia e Shtetit dhe tarifat e pagesës për personat juridikë e fizikë, publikë apo privatë". Çdo person mund të bëjë një kërkesë online për ofrimin e shërbimeve nga Policia e Shtetit. Një përgjigje pranimit ose refuzimit do të jepet brenda dyzet e tetë orëve. Shërbimet janë të lidhura me organizimin e ngjarjeve kulturore e sportive kombëtare ose ndërkombëtare, përdorimin e uniformës së policisë, armëve, automjeteve dhe ambienteve për qëllime kinematografike, shoqërimin e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme, mbrojtjen dhe sigurinë e përkohshme të subjekteve strategjike ose investimeve.

²¹ <https://www.asp.gov.al/category/donacione/>

²² Shih për shembull, <https://www.asp.gov.al/programi-i-sigurise-se-shteteve-te-bashkuara-te-amerikes-dhuron-per-policine-e-shtetit-pajisje-per-kontrollin-dhe-mbikeqyrjen-e-kufirit/> publikuar më 5 shkurt 2022, <https://www.asp.gov.al/policia-federale-gjermane-donacion-per-repartin-special-renea/> publikuar më 16 shkurt 2022 ; <https://www.asp.gov.al/policia-e-shtetit-marreveshje-me-optiken-luani-per-sherbime-dhe-produkte-me-cmim-te-reduktuar/> publikuar më 19 shkurt 2022

²³ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/09/07/591/0728c0fa-65a0-4241-bb84-5cf1748f8bf4;q=MIRATIMIN%20E%20LLOJEVE%20T%C3%8B%20SH%8BRBIMEVE%20SHITES%3%8B%20Q%C3%8B%20FRON%20POLICIA%20E%20SHTETIT%20DHE%20TARIFAVE%20T%C3%8B%20PAGES%3%8B%20P%20POLICIA%20E%20SHTETIT%20DHE%20TARIFAVE%20T%C3%8B%20PAGES%3%8B%20P%20PER%20CID%8B%20E%20FIZIK%3%8B,%20PUBLIK%3%8B%20OSE%20PRIVAT%3%8B>

67. GRECO vëren miratimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave për ofrimin nga Policia e Shtetit të shërbimeve shtesë në këmbim të pagesës. Megjithatë, ai shpreh keqardhjen që aty nuk është përmendur asgjë për kryerjen e një vlerësimi të rreziqeve të korrupsionit dhe konflikteve të interesit që lidhen me ofrimin e shërbimeve me pagesë nga Policia e Shtetit, siç përcaktohet në paragrafin 150 të Raportit të Vlerësimit. Ai nuk mund ta konsiderojë këtë rekomandim të zbatuar, qoftë edhe pjesërisht.

68. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xiv nuk është zbatuar .

Rekomandimi xv

69. *GRECO ka rekomanduar që plani i integritetit për Policinë e Shtetit të zbatohet me përparësi.*

70. Autoritetet shqiptare raportojnë se plani i integritetit për vitet 2018-2020, i referuar në paragrafët 157-158 të Raportit të Vlerësimit, është zbatuar në praktikë duke marrë masa për forcimin e integritetit dhe uljen e korrupsionit në Polici. Ato i referohen, ndër të tjera, masave në lidhje me rivlerësimin e personave dhe certifikatat përkatëse të sigurisë që japin akses në informacionin e klasifikuar, përmirësime në kryerjen e testeve psikologjike dhe intervistave me gojë për rekrutët e rinj, një rregull mbi procedurën për kryerjen e vlerësimeve të performancës (duke u vënë re se nuk është bërë vlerësimi i përfundimit të ushtrimit të performancës), procedurave standarde të funksionimit për pranimin dhe administrimin e dhurimeve dhe ndjekjen e rasteve të konfliktit të interesit dhe ushtrimit të veprimtarive dytësore. Autoritetet kanë dhënë këtë informacion dhe të dhëna të tjera statistikore në një raport prej 16 faqesh për statusin e zbatimit për vitin 2021. Më tej, ata raportojnë se plani i ri i integritetit të Policisë së Shtetit për vitet 2022-2024 është miratuar më datë 24 qershor 2022 dhe është vënë në dispozicion online²⁴.

71. GRECO merr shënim masat e raportuara nga autoritetet për të zbatuar, si çështje me përparësi, planin e integritetit për periudhën 2018-2020. Ajo risjell në vëmendje se plani i integritetit 2018-2020 ishte temë e përfshirë në Raportin e Vlerësimit. Për këtë arsye, vlerësimi i GRECO-s për përputhmërinë e autoriteteve me këtë rekomandim kufizohet në atë plan integriteti, i cili ndërkohë është zëvendësuar nga një plan i ri integriteti që mbulon periudhën 2022-2024. GRECO vlerëson se, në funksion të masave të përshkruara në raportin për statusin e zbatimit të vënë në dispozicion nga autoritetet në lidhje me zbatimin e planit të integritetit 2018-2020, ky rekomandim është trajtuar në mënyrë të kënaqshme.

72. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xv është trajtuar në mënyrë të kënaqshme.

Rekomandimi xvi

73. *GRECO ka rekomanduar që parimet etike dhe rregullat e sjelljes të përfshira në Rregulloren e Policisë së Shtetit të plotësohen me një manual që përmban udhëzime praktike që merr parasysh specifikat e Policisë së Shtetit, shumëllojshmërinë e detyrave dhe dobësitë.*

²⁴ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Urdh%C3%ABr-Nr782-dt.24.06.2022-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-PLANIT-T%C3%8B-INTEGRITETIT-T%C3%8B-POLICIS%C3%8B-S%C3%8B-SHTETIT-DHE-PLANIT-T%C3%8B-VEPRIMIT-2022-2024.pdf>

74. Autoritetet shqiptare raportojnë se është vënë në dispozicion online²⁵ një Manual për Etikën dhe Integritetin në Policinë e Shtetit, i cili përmban një përmbledhje të dispozitave të ndryshme ligjore të përfshira në Ligjin për Policinë e Shtetit, Rregulloren e Policisë së Shtetit, Ligjin për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, të caktuar ose që ushtrojnë funksione publike.

75. GRECO vëren se Manuali i Etikës dhe Integritetit është një përmbledhje tekstesh ligjore dhe i mungon çdo udhëzim praktik në formën e shembujve dhe shpjegimeve konkrete në lidhje me sjelljen e pritshme nga punonjësit e policisë, duke marrë parasysh specifikën, shumëllojshmërinë e detyrave dhe dobësitë e Policisë së Shtetit. Për këtë arsye, ai nuk mund ta konsiderojë këtë rekomandim të zbatuar, qoftë edhe pjesërisht.

76. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xvi nuk është zbatuar.

Rekomandimi xvii

77. *GRECO ka rekomanduar (i) shtimin e trajnimit fillestar dhe gjatë punësimit të punonjësve të policisë në lidhje me çështjet e integritetit, si dhe trajnimin e specializuar të hetuesve që merren me çështjet e korrupsionit dhe krimit ekonomik; (ii) ngritjen e një sistemi dhe caktimin e personave të trajnuar të besimit për të ofruar këshillim konfidencial mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë.*

78. Autoritetet shqiptare raportojnë se, për sa i përket pjesës (i) të rekomandimit, Akademia e Sigurisë ka hartuar një program mësimor të ri për trajnimin fillestar të punonjësve të policisë, që mbulon lëndët e mëposhtme: (i) lufta kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit, (ii) sjellja e policisë – sjellja e papërshtatshme, pasojat e saj dhe rëndësia e raportimit, (iii) imazhi profesional dhe kultura organizative e policisë dhe (iv) kuadri ligjor dhe rregullator për integritetin e policisë. Nga dhjetori 2020 deri në tetor 2021, janë organizuar disa veprimtari trajnuese, me gjithsej 302 oficerë policie, me tematikat e mëposhtme: vepra penale të lidhura me detyrën, pastrimin e parave dhe hetimin financiar dhe pasuror, zbatimimi i planit të integritetit, trajnime për analizën e integritetit dhe rreziqeve për korrupsionin në polici, menaxhimin e hetimeve paralele, korrupsionin pasiv të zyrtarëve shtetërorë, hetimin proaktiv të veprës penale të fshehjes së pasurisë, financimin e terrorizmit, hetimin e pasurisë, qarkullimin e parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal, evazionin fiskal dhe krimin kibernetik. Hetuesit e BKH-së kanë përfutur gjithashtu edhe një sërë trajnimesh të organizuara nga partnerë ndërkombëtarë mes muajve tetor 2021 dhe janar 2022 me tema të tilla, si praktikatat e mira për hetimin dhe ndjekjen penale të personave juridikë për veprat penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave. Për sa i përket pjesës (ii), me Urdhrin nr. 1235, datë 14 dhjetor 2021, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka ngritur një njësi përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konflikteve të interesit në Policinë e Shtetit, detyra kryesore e së cilës do të konsistojë në sigurimin e plotësimin të detyrës të deklaratave të interesave nga ana e punonjësve të policisë dhe bashkëpunimin me ILDKPKI. Njësia përbëhet nga 13 punonjës që punojnë kryesisht në drejtorinë e burimeve njerëzore, nga të cilët tre persona janë caktuar posaçërisht për të dhënë konsulencë në parandalimin e konfliktit të interesit. Në muajin shkurt

²⁵ <https://www.asp.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/MANUALI-I-ETIKES-DHE-INTEGRITETIT-NE-POLICINE-E-SHTETIT.pdf>

2022 është mbajtur një trajnim i veçantë për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private në formë elektronike.

79. Për sa i përket pjesës (i) të rekomandimit, GRECO merr shënim informacionin e dhënë nga autoritetet, veçanërisht programin fillestar të trajnimit për oficerët e policisë dhe aktivitetet e ndryshme të trajnimit gjatë punësimit të organizuara për oficerët e policisë dhe hetuesit e BKH-së. Ndonëse këto janë pa dyshim zhvillime pozitive, paragrafi 169 i Raportit të Vlerësimit e ka lidhur këtë aspekt të rekomandimit me hartimin e një “manuali” që përmban shembuj nga përvoja reale në Policinë e Shtetit, i cili do të ofronte një pikë referimi dhe një mjet udhëzues të vërtetë funksional (shih gjithashtu rekomandimin xvi më lart). Sipas mendimit të GRECO-s, parimet etike dhe rregullat e sjelljes të përfshira në Rregulloren e Policisë së Shtetit, që do të plotësohen me manualin që përmban udhëzime praktike, duhet të përbëjnë shtyllën e edukimit policor për të gjitha çështjet përkatëse të integritetit gjatë gjithë karrierës së një punonjësi policie. Për këtë arsye, ndërkohë që GRECO vëren se është arritur progres, ai konsideron se zbatimi i plotë i pjesës (i) të rekomandimit varet nga miratimi i manualit me udhëzime praktike.

80. Për sa i përket pjesës (ii) të rekomandimit, GRECO vëren krijimin e një njësie e cila nuk merret ekskluzivisht me ofrimin e këshillimit konfidencial. Megjithatë, ai përbëhet nga tre persona të cilët janë caktuar për të dhënë këshilla për parandalimin e konfliktit të interesit. GRECO dëshiron të ketë informacion shtesë në lidhje me funksionimin e sistemit të këshillimit konfidencial në të ardhmen, veçanërisht shtrirjen e tij në të gjithë vendin, trajnimet specifike për këta tre anëtarë për çështjet e etikës dhe integritetit, natyrën e çështjeve të trajtuara, dhe masën e këshillave të ofruara, në mënyrë që të arrihet përmbushja e plotë e kësaj pjese të rekomandimit.

81. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xvii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xviii

82. *GRECO ka rekomanduar marrjen e masave për rritjen e qëndrueshmërisë së drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, pavarësisht ndryshimeve politike në vend.*

83. Autoritetet shqiptare theksojnë se Policia e Shtetit e ka trajtuar me rigorozitet këtë rekomandim dhe ka respektuar legjislacionin për emërimin/shkarkimin e drejtuesve të saj të lartë. Ato i referohen disa dispozitave ligjore në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të drejtorive. Ata kanë dhënë gjithashtu informacione për disa pozicione të nivelit të lartë të cilat janë mbuluar nga i njëjti person gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 për të demonstruar qëndrueshmërinë e drejtimit në nivel të lartë.

84. GRECO merr shënim informacionin e dhënë nga autoritetet. Ai konsideron se gjendja ka mbetur e pandryshuar, pasi janë të njëjtat dispozita ligjore ekzistuese dhe e njëjta situatë e krijuar që në kohën e miratimit të Raportit të Vlerësimit. GRECO nuk shquan miratimin e ndonjë mase konkrete për zbatimin e këtij rekomandimi. Gjithashtu, nevojiten statistika të krijuara prej kohësh për të demonstruar qëndrueshmërinë e drejtimit të nivelit të lartë në pozicionet e tyre, të paktën për kohëzgjatjen e një mandati të plotë katërvjeçar, veçanërisht kur ka ndryshime politike.

85. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xviii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xix

86. *GRECO ka rekomanduar që drejtuesit e drejtorive të Policisë së Shtetit të emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm.*

87. Autoritetet shqiptare raportojnë se nuk ka ndryshime në procedurën e emërimit të drejtuesve të drejtorive të Policisë së Shtetit. Sipas Ligjit për Policinë e Shtetit (nr. 108/2014, i ndryshuar), Policia e Shtetit është e organizuar në bazë shërbimi dhe e specializuar në Policinë e Hetimit Kriminal, në Policinë e Sigurisë Publike dhe në Policinë e Kufirit dhe Migracionit për shkaqe që lidhen me arsimin, kualifikimin, gradat, detyrat dhe përgjegjësitë. Duke qenë se këto drejtori shërbejnë dhe mbulojnë fusha të identifikuar në mënyrë specifike, autoritetet parashtrajnë se ato funksionojnë si agjenci kombëtare dhe aktivitetet e tyre bazohen në ligje të tjera organike, duke u dhënë atyre një natyrë dhe identitet të caktuar. Në vend të kësaj, ata argumentojnë se emërimi i drejtuesve të drejtorive nga Ministri i Brendshëm nuk cenon pavarësinë operationale të Policisë së Shtetit.

88. GRECO vëren se, përveç forcave të specializuara të policisë, Policia e Shtetit është një institucion i centralizuar (neni 19 i Ligjit për Policinë e Shtetit). Drejtuesi i një drejtorie, pjesë përbërëse e organikës së Policisë së Shtetit, përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm (neni 10/1 i Ligjit për Policinë e Shtetit) dhe duhet të emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me kërkesat e rekomandimit. Ajo konsideron se nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi.

89. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xix nuk është zbatuar .

Rekomandim xx

90. *GRECO ka rekomanduar i) që funksionet më të ekspozuara ndaj rreziqeve të integritetit të kenë përparësi gjatë procesit të rivlerësimit (vetingut), në lidhje me planin e integritetit dhe mjetet e tjera ekzistuese të menaxhimit të rrezikut; dhe ii) që kontrollet për integritetin e kandidatëve të kryhen në kontekstin e ndryshimeve të pozicioneve dhe ngritjes në detyrë dhe në intervale të rregullta gjatë karrierës së punonjësve të policisë.*

91. Autoritetet shqiptare raportojnë se, sipas ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 12/2018 për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit (Ligji i Vetëingut të Policisë), i miratuar në muajin mars 2021²⁶, procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit është pezulluar deri në përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA). Ndërkohë, në vitin 2021 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 128/2021 për krijimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), e cila ka zëvendësuar SHÇBA dhe do të ushtrojë autoritet mbikëqyrës për tre subjekte: Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Shërbimin Zjarrfikës dhe Mbrojtjes e Shpëtimit. AMP do të jetë përgjegjëse, ndër të tjera, për kryerjen e rivlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë, hetimin disiplinor për shkelje të dyshuara të rënda disiplinore, luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e veprimtarive të paligjshme në radhët e tre subjekteve që i janë ngarkuar të mbikëqyrë. Në zbatim të ndryshimeve ligjore në ligjin e Vetëingut të Policisë, AMP i ka siguruar Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJE), organit

²⁶ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/03/08/30>

përgjegjës për kryerjen e vlerësimit kalimtar të zyrtarëve më të lartë dhe stafit të AMP, një listë me 42 punonjës që do t'i nënshtrohen vlerësimin kalimtar. Si pasojë, procedura e vlerësimin kalimtar kanë përfunduar për 13 punonjës të AMP.

92. Gjithashtu, në muajin nëntor 2021 Ministri i Brendshëm ka ngritur një grup pune për të propozuar ndryshime të mëtejshme në ligjin e vlerësimin kalimtar të policisë si rezultat i disa mangësive të identifikuara, si: (i) mospërmbushja në kohë dhe në mënyrë efektive e kërkesave që burojnë nga ligji i brendshëm për shkak të numrit të lartë të punonjësve të policisë - 12,000 anëtarë - të cilët do t'i nënshtrohen vlerësimin kalimtar dhe do të zgjasin më shumë se 10 vjet; (ii) dështimi për të përcaktuar qartë në legjislacionin e brendshëm periudhën kohore në lidhje me të cilën do të kryhej verifikimi i pasurive të deklaruara; (iii) mungesa e një metodologjie për kryerjen e një analize financiare të kursimeve dhe mundësive që kanë pasur personat dhe personat e tjerë të lidhur për blerjen e pasurive jashtë burimeve të ligjshme, (iv) paqartësia e dispozitave ligjore në lidhje me kontrollin e figurës për sa i përket fushës, standardeve dhe rrethanave, (v) mungesa e kriterëve objektive në vlerësimin e aftësive profesionale si rezultat i vlerësimit të tre dokumenteve të hartuara nga personi që do të verifikohet, (vi) mosparashikimi në ligj i rasteve të dorëheqjes së punonjësve të policisë gjatë hetimit administrativ dhe (vii) mosparashikimin e detyrimit të institucioneve për zbatimin e vendimeve. Ndryshimet ligjore, të cilat i janë përcjellë Kuvendit më datë 4 gusht 2022²⁷, synojnë: (i) reduktimin e numrit të personave që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit kalimtar mbi bazën e dy kriterëve kumulative: pozicionit drejtues/vendimmarrës dhe rreziqet/cënueshmëria ndaj aktiviteteve korruptuese. Ndryshimet e propozuara kanë evidentuar këto pozicione që do t'i nënshtrohen vlerësimit kalimtar: (1) në Policinë e Shtetit: Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, drejtorët e drejtorive, drejtori i drejtorisë qendrore, drejtori i shërbimeve speciale, drejtori vendor dhe zv. drejtori, drejtor në drejtorinë e kufirit dhe migracionit, shefi i policisë, shefi i njësisë në nivel qendror dhe vendor përgjegjës për krimin e organizuar, krimin ekonomik/financiar dhe policinë rrugore; (2) në Gardën e Republikës: Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, drejtori i drejtorisë dhe shefi i njësisë; (3) në AMP: Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i njësisë dhe punonjësit e stafit që punojnë në njësinë përgjegjëse për procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik; (ii) ndërprerjen e funksionimit të KJE-së dhe transferimin e kompetencave të saj tek AMP, e cila do të kryejë procesin kalimtar dhe periodik të vlerësimit; ; (iii) futjen e procesit periodik të vlerësimit, çdo pesë vjet, për anëtarët e stafit që i janë nënshtrohet me sukses vlerësimit në mënyrë që të shqyrtohen ndryshimet që mund të kenë ndodhur në lidhje me tre komponentët e rivlerësimit (dmth, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale).

93. GRECO merr shënim pezullimin e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit deri në përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, i cili rezulton të jetë një ndalim i përkohshëm i procesit të vlerësimit kalimtar të të gjithë punonjësve të policisë. Ndryshimet në ligjin e vlerësimit kalimtar të policisë kanë identifikuar në mënyrë specifike funksionet më të ekspozuara ndaj rreziqeve të integritetit, të cilët do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit fillestar dhe periodik. Në pritje të kalimit dhe hyrjes në fuqi të ndryshimeve legjislative²⁸, GRECO konsideron se pjesa (i) e rekomandimit është përmbushur vetëm pjesërisht. Për sa i përket pjesës (ii), GRECO mirëpret që ndryshimet legjislative të propozuara parashikojnë vlerësimin periodik, çdo pesë vjet, për

²⁷ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55755>

²⁸ Autoritetet kanë raportuar se më 17 nëntor 2022 parlamenti ka miratuar ndryshimet ligjore.

anëtarët e stafit që i janë nënshtruar verifikimit fillestar. Gjithashtu, duhet theksuar se kërkesat e pjesës (ii) kërkojnë gjithashtu që autoritetet të kryejnë kontrolle mbi integritetin e kandidatëve në kuadër të ndryshimit të pozicionit dhe promovimit. Në këto rrethana, GRECO vlerëson se kjo pjesë e rekomandimit nuk është përmbushur më shumë se pjesërisht.

94. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xx është zbatuar pjesërisht.

Rekomandim xxi

95. *GRECO ka rekomanduar që rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhurimeve nga stafi i policisë t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe zbatimit të duhur.*

96. Autoritetet shqiptare i janë referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 789, datë 24 qershor 2022, për miratimin e procedurave standarde të funksionimit që përcaktojnë rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhuratave. Përveç informacionit të përshkruar në paragrafët 209-210 të Raportit të Vlerësimit, Urdhri përfshin një seksion mbi procedurat në lidhje me ndalimin e dhuratave dhe përfitimeve të tjera, një seksion për trajtimin e dhuratave protokollare, të cilat do të regjistrohen në bazë të një shtojce bashkangjitur, dhe një seksion për vlerësimin e dhuratave që tejkalojnë një prag të caktuar, i cili do të kryhet nga një komision vlerësimi. Në vitin 2022 nuk janë raportuar raste të pranimit dhe deklarimit të dhuratave nga punonjësit e policisë.

97. GRECO merr shënim Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm për pranimin dhe deklarimin e dhuratave, në veçanti modalitetet për respektimin e ndalimit të pranimit të dhuratave, trajtimin e dhuratave protokollare dhe vlerësimin e dhuratave që tejkalojnë një prag të caktuar, dhe konsideron se mbikëqyrja e tij dhe zbatimi duhet të mbahet nën shqyrtim.

98. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xxi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxii

99. *GRECO ka rekomanduar që punonjësit e 'Illyrian Guard' t'i nënshtrohen të njëjtave masa ligjore dhe rregullatore (përfshirë rregullat e zbatueshme të sjelljes dhe rregullat e transparencës në procedurat e prokurimit publik) si punonjësit e Policisë së Shtetit .*

100. Autoritetet shqiptare raportojnë se në muajin tetor 2020 administratori i 'Illyrian Guard' ka miratuar një urdhër për "Procedurat e menaxhimit të personelit në 'Illyrian Guard'", duke rregulluar ndër të tjera procedurat e rekrutimit, transferimit, promovimit, vlerësimit, pushimit nga puna dhe procedurat disiplinore të punonjësve të saj. Njoftimet për vende të lira pune do të publikohen në faqen e saj²⁹ dhe aplikimet mund të bëhen online³⁰. Të gjitha prokurimet kryhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimet Publik (Ligji nr. 162/2020 për Prokurimin Publik³¹). Gjithashtu, një vendim i fundit i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë më 22 nëntor 2021³² ka konstatuar se ngritja e 'Illyrian Guard' ka qenë në përputhje dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit për Policinë e Shtetit, i cili parashikon sigurimin nga ana e Policisë së

²⁹ <https://illyrianguard.al/njoftime/>

³⁰ <https://illyrianguard.al/rekrutime/>

³¹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/12/23/162>

³² http://www.gjykataelarte.gov.al/web/242_00_2021_1939_7431.doc

Shtetit të shërbimeve shtesë, kundrejt tarifës, të personave publikë ose privatë, juridikë ose fizikë. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se llojet e shërbimeve që 'Illyrian Guard' do të ofrojë kundrejt pagesës së një tarife janë në përputhje dhe në përmbushje të misionit të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjen e personaliteteve shtetërore dhe objekteve me rëndësi të veçantë, dhe siguron zbatimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe të drejtën ndërkombëtare.

101. GRECO vëren se urdhri i administratorit të 'Illyrian Guard' duket se shkon në drejtimin e duhur. Megjithatë, përmbajtja e tij e plotë nuk është përcjellë për shqyrtim nga GRECO. Ai gjithashtu merr parasysh vendimin e fundit të Gjykatës së Lartë Shqiptare, i cili nuk hedh asnjë dritë mbi zbatimin e të njëjtave masa ligjore dhe rregullatore ndaj punonjësve të 'Illyrian Guard' (përfshirë rregullat e detyrueshme të sjelljes dhe rregullat e transparencës në procedurat e prokurimit publik) si ndaj punonjësve të policisë së shtetit.

102. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xxii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxiii

103. *GRECO ka rekomanduar hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv zbatues, për punonjësit e policisë.*

104. Autoritetet shqiptare raportojnë se e drejta e punësimit është një e drejtë kushtetuese, në lidhje me të cilën kualifikimet, kriteret, kushtet dhe kufizimet përcaktohen në legjislacionin kombëtar, nga vetë personat juridikë privatë ose publikë. Sipas tyre, nuk është as e arsyeshme dhe as e nevojshme që Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të miratojnë një instrument, i cili do të vendoste kufizime pas largimit nga detyra për ish-policët, pasi kjo shkon përtej kompetencave të tyre.

105. GRECO vëren se nuk është bërë asnjë ndryshim në sistem, të përfshirë në Raportin e Vlerësimit dhe që ka çuar në rekomandimin e lartpërmendur. Për këtë arsye, autoriteteve u kërkohet të shqyrtojnë hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv zbatues.

106. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xxiii nuk është zbatuar.

Rekomandim xxiv

107. *GRECO ka rekomanduar që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, duke përfshirë trajnimin dhe informimin e rregullt të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizuesve.*

108. Autoritetet shqiptare raportojnë se më 25 tetor 2021 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shteti ka miratuar një rregullore të brendshme për "Sinjalizuesit, hetimin administrativ dhe mbrojtjen nga hakmarrja" (Rregullorja e Policisë për Sinjalizuesit). Sipas Rregullores së Policisë për Sinjalizuesit, është ngritur një njësi e brendshme për sinjalizuesit, e cila përbëhet nga dy anëtarë të stafit të zyrës së auditit të brendshëm. Raportet mund të bëhen me shkrim, nëpërmjet përdorimit të një formulari model që i bashkëlidhet Rregullores së Policisë për Sinjalizuesit, ose verbalisht përpara njësisë së brendshme të sinjalizuesve. Njësia është përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e provave, kryerjen e hetimit administrativ,

vendosjen për pushimin e hetimit ose mosfillimin e tij, si dhe urdhërimin e masave të brendshme për mbrojtjen e sinjalizuesve nga çdo hakmarrje.

109. Njoftimet për ekzistencën e njësisë së brendshme të sinjalizuesve janë vënë në të gjitha komisariatet. Në datat 6 dhe 8 tetor 2021, Akademia e Sigurisë organizoi dy trajnime për legjislacionin e sinjalizuesve, ku morën pjesë 39 punonjës policie. Programi mësimor i trajnimit është përgatitur nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Trajnime shtesë janë planifikuar edhe për vitin 2022.

110. GRECO mban shënim miratimin e Rregullores së Policisë për Sinjalizuesit dhe ngritjen e një njësie të brendshme të sinjalizuesve. Ai thekson gjithashtu se ekzistenca e njësisë së brendshme të sinjalizuesve është bërë e dukshme në komisariatet e policisë në të gjithë vendin. Ai më tej konsideron se trajnimet fillestare të organizuara për rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e sinjalizuesve janë hapa në drejtimin e duhur. Megjithatë, duke pasur parasysh sasinë e madhe të punonjësve të Policisë së Shtetit prej gati 12,000 punonjësish, këto masa duken të pamjaftueshme. GRECO u bën thirrje autoriteteve të shtojnë përpjekjet e tyre dhe të shumëfishojnë aktivitete të tilla trajnimi në intervale të rregullta në të ardhmen, për të gjitha nivelet e hierarkisë dhe zinxhirët komandues në Policinë e Shtetit.

111. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi xxiv është zbatuar pjesërisht.

III. PËRFUNDIME

112. **Duke pasur parasysh sa më sipër, GRECO arrin në përfundimin se Shqipëria ka zbatuar në mënyrë të kënaqshme ose ka trajtuar në mënyrë të kënaqshme vetëm pesë nga njëzet e katër rekomandimet e përfshira në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Pestë.** Nga rekomandimet e mbetura, trembëdhjetë janë zbatuar pjesërisht dhe gjashtë nuk janë zbatuar.

113. Më konkretisht, rekomandimet i, x, xi, xii dhe xv janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme ose janë trajtuar në mënyrë të kënaqshme, rekomandimet ii, iii, iv, v, vi, vii, viii, xiii, xvii, xx, xxi, xxii dhe xxiv, janë zbatuar pjesërisht dhe rekomandimet ix, xiv, xvi, xviii, xix dhe xxiii nuk janë zbatuar.

114. Në lidhje me pushtetin qendror (personave të cilëve u janë besuar funksione të larta ekzekutive), sistemi elektronik i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave është bërë funksional dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Vlerësimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit është plotësuar me burimet e nevojshme për të kryer verifikimin efikas të deklaratave. Përveç kësaj, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit është bërë funksionale, Byroja Kombëtare e Hetimit është plotësuar me personel të plotë dhe duket se personeli i saj ka marrë trajnimin e duhur të specializuar. Për më shumë, janë miratuar plane integriteti në njëmbëdhjetë ministri, emrat, detyrat kryesore dhe aktivitetet ndihmëse të të gjithë këshilltarëve politikë janë bërë publike dhe janë futur disa rregulla se si personat me funksione të larta ekzekutive të angazhohen në kontaktet me lobistët. Megjithatë, kërkohet veprime të mëtejshme në një sërë fushash në lidhje me përgatitjen e udhëzimeve dhe shembujve ilustrues për Kodin Ministror, forcimin e pavarësisë së Komisionit të Etikës nga ndikimi jo i përshtatshëm nga ekzekutivi dhe funksionimi i tij efektiv, organizimin e trajnimeve të rregullta për tematika në lidhje me integritetin për anëtarët e Qeverisë dhe këshilltarët politikë, krijimin e kanaleve efikase të këshillimit konfidencial dhe futjen e kufizimeve pas largimit nga detyra.

115. Sa i përket agjencive të zbatimit të ligjit, është bërë njëfarë progresi në disa fusha. Janë publikuar donacionet dhe sponsorizimet, janë marrë masa për zbatimin e planit të integritetit 2018-2020. Për më tepër, vihet re se një plan i ri integriteti 2022-2024 është në fuqi, trajnimi fillestar i oficerëve të policisë mbulon çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ndërsa organizimi i trajnimit gjatë punësimit është i kushtëzuar me hartimin e një manuali që përmban udhëzime praktike dhe reale nga shembuj nga jeta, janë emëruar tre këshilltarë konfidencialë, ka hyrë në fuqi një urdhër i ri për pranimin dhe deklarimin e dhuratave, është ngritur një njësi e brendshme për mbrojtjen e sinjalizuesve në Policinë e Shtetit dhe është ofruar një trajnim fillestar për një pjesë të vogël oficerësh policie për masat mbrojtëse të sinjalizuesve. Thënë kjo, kërkohet një veprim domethënës në një sërë fushash të tjera: politika që Policia e Shtetit të ofrojë shërbime shtesë në këmbim të pagesës duhet të marrë parasysh rreziqet për korrupsion dhe konfliktet e interesit, një manual që përmban udhëzime praktike duhet të plotësojë parimet etike dhe rregullat e sjelljes që përmban Rregullorja e Policisë së Shtetit, duhet forcuar qëndrueshmëria e drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, drejtuesit e drejtorive të Policisë së Shtetit duhet të emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm, duhet të ketë kufizime të qarta pas largimit nga detyra, si dhe duhet të futet një mekanizëm efektiv zbatimi, dhe praktika e dhurimeve dhe sponsorizimeve për policinë duhet t'i nënshtrohet një analize të gjerë për të kufizuar rreziqet për korrupsion dhe konflikt interesi.

116. Duke pasur parasysh sa më sipër, GRECO vëren se progresi i mëtëjshëm është i nevojshëm për të demonstruar një nivel të pranueshëm përputhshmërie me rekomandimet brenda 18 muajve të ardhshëm. Në vijim të Rregullit 31 bis të ndryshuar, paragrafit 8.2 të Rregullores së tij të Procedurës, GRECO fton kreun e delegacionit të Shqipërisë të paraqesë informacione shtesë në lidhje me zbatimin sa më shpejt të jetë e mundur të rekomandimeve të papërbushura (domethënë nga ii deri në ix, xiii, xiv dhe xvi deri në xxiv), sidoqoftë - maksimumi deri më 30 qershor 2024.

117. Së fundmi, GRECO fton autoritetet shqiptare që të autorizojnë publikimin e raportit, sa më shpejt të jetë e mundur.